

Shkëlqesia e Tij Prof. Dr. Milan Jazbec, Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë

Është ambasadori i gjashtë i Republikës së Sllovenisë në Republikën e Maqedonisë Veriore nga shtatori i vitit 2016 (paraqiti letrat kredenciale të enjten, 28 shtator) dhe gjithashtu profesor i diplomacisë në Universitetin e Lubjanës (ligjërues i diplomacisë në Shkollën Pasuniversitare të Punëve Qeveritare dhe Evropiane në Kranj).

Ai ishte ambasadori i katërt slloven në Turqi (2010-2015), i akredituar edhe në Azerbajxhan, Iran, Irak, Liban dhe Siri. Ka shërbyer si ministër fuqiptotë në ambasadën sllovene në Stokholm (1996-2000, mbulim diplomatik i pesë shteteve nordike dhe tre shteteve baltike) dhe ishte konsulli i fundit jugosllav në Klagenfurt (1991) si dhe konsulli i parë slloven (1992-1995). Ka qenë sekretar shteti në Ministrinë sllovene të mbrojtjes (2000-2004), Drejtor i departamentit për shtetet evropiane në Ministrinë e punëve të jashtme (2015-2016), Drejtor i planifikimit të politikave dhe kërkimeve (2006-2010) dhe Drejtori i departamentit konsullor (1996).

Ai është autor, bashkautor, redaktor dhe bashkeditor i 48 librave të botuara në tetë gjuhë (një të tretën e tyre në diplomaci) dhe më shumë se njëqind artikuj mbi çështjet e diplomacisë, sigurisë dhe mbrojtjes. Kreu doktoraturën në Universitetin e Klagenfurtit (2000), përfundoi shkollën për diplomaci në Beograd (1988) dhe u diplomua në gazetari (1981) dhe studimet e mbrojtjes (1983) në Fakultetin e Shkencave Sociale në Lubjanë.

Ka karrierë të gjatë dhe të shquar në sferën e diplomacisë, biznesit, gazetarisë dhe politikës. Ligjëron në universitete të ndryshme, si në Columbia të Nju Jork-ut, Akademinë Diplomatike në Vjenë, universitetet Bilkent, Metu si dhe në universitetin e Ankarasë. Është anëtar i Shoqatës sllovene për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Shoqatës Sllovene të Shkencave Politike si dhe redaktor i revistës ndërkombëtare European Perspective dhe anëtar i PEN-it slloven.

Kreu shërbimin e tij ushtarak në qytetin maqedonas të Shtipit nga tetori 1981 deri në mars 1982.

Në mars të vitit 2005 ai pranoi dekorimin e lartë të shtetit austriak, Dekorimi i Lartë i Artë i Nderit me Yll për Merita të Republikës së Austrisë. Ai shkruan blog mujor për Diplo.